



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:237872

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06253825

**P.nr.452/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË –Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona LAJQI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1762/2023 të datës 06.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 04.09.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit A.Xh., dhe i pandehuri A.P., me datë 05.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.10.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

A.P., nga i ati S....., e ëma H....., e vajzërisë S..., i lindur me datë ....., në Mitrovicë, me vendbanim në Rrugën “.....”, Mitrovicë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

Më datën ....., rreth orës ....., në Mitrovicë, në rrugën “.....”, i pandehuri me qëllim dhe pa autorizim posedon substancë narkotike, ashtu që, zyrtarët policor gjatë patrullimit të tyre në rrugën e lartcekur, kishin ndaluar veturën ....., të cilin veturë e kishte marr me qira i pandehuri dhe pas legjitimit të tij, tek i njëjti kishin gjendur katër (4) qese me substancë narkotike të llojit marihuane, e cila është sekuestruar dhe pas ekzaminimit, në laborator të Forenzikës është

konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis-marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 2.08 gram,

-Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70, e lidhur me nenin 269 par.1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, dhe 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

### **G J Y K O N**

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300.00 (treqind) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. DËNIM ME BURGIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- III. Në mbështetje të nenit 269 par.3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 par.2 nënpar.2.4 të KPP-së, nga i akuzuari KONFISKOHEN sendet, dhe atë: Substancë narkotike M....., në sasi prej .... gram dhe Urdhërohet Policia e Kosovës që të njëjtën ta shkatërroje, sipas procedurave ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit të dhunshëm.
- V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2085/23 të datës 12.12.2023 kundër të pandehurit A.P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.09.2024, në të cilën kanë prezantuar A.Xh., dhe i pandehuri A.P.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem. Tutje ka theksuar se është i penduar, dhe po ashtu ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Prokurori i Shtetit A.Xh. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lëndës, prandaj i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim të merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa si rrethana rënduese të merr parasysh dashjen e kryerjes së veprës penale, rrezikimin e vlerës së mbrojtur, dëmin e shkaktuar dhe të pandehurit ti shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti policor me numër të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-MIJ-89, nga zyrtari A... M..., Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 08.09.2023, Informacionet për të kaluarën kriminale e marr nga data baza e policisë së Kosovës, Foto dokumentacioni, Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit A.P. i datës 11.09.2023, si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari A.P. ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese në këtë rast, gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, faktin se këto vepra janë gjithnjë e në rritje në vendin tonë. Ndërsa, si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, premtimin e dhënë gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, si dhe ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit sa i përket veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet për shqiptim të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e

moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin për konfiskimin e substancës narkotike gjykata e mori në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK dhe nenit 276 të KPP-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata nuk ka vendosur, pasi që aktakuzë nuk ka propozuar palë të dëmtuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 449, 450, dhe 452 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.452/2023, datë 04.10.2024**

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona LAJQI

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.